



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 167

Tiranë – E enjte, 18 shtator 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 57/2025, datë 16.9.2025	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e rregullores së Kuvendit të Shqipërisë”, të ndryshuar	21435
Vendim i Kuvendit nr. 58/2025, datë 16.9.2025	Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të Kuvendit.....	21436
Vendim i Kuvendit nr. 59/2025, datë 16.9.2025	Për përbërjen e sekretariateve të Kuvendit.....	21436
Vendim i Kuvendit nr. 60/2025, datë 16.9.2025	Për përbërjen e Byrosë së Kuvendit.....	21437
Vendim i Kuvendit nr. 61/2025, datë 16.9.2025	Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit...	21437
Urdhër i Kryetarit të Kuvendit nr. 7, datë 17.9.2025	Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë.....	21438
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 120, datë 1.9.2025	Për delegim kompetence.....	21439
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 121, datë 1.9.2025	Për delegim kompetence.....	21440
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 570, datë 12.9.2025	Për delegim kompetence.....	21441



VENDIM
Nr. 57/2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË
KUVENDIT TË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe neneve 55 e 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Kuvendi miraton në seancë plenare ngritjen e 11 komisioneve të përhershme me emërtesat dhe fushat e përgjegjësisë si më poshtë:

- Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat.

(Çështjet e politikave ekonomike me përqasjen ndaj tregut të përbashkët evropian, Buxhetin e Shtetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij, marrëdhëniet e punësimit, lirisë së lëvizjes së punëtorëve, financat publike, privatizimet dhe sistemin bankar.)

- Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike.

(Kodet dhe ligjet duke garantuar përputhshmërinë dhe zbatueshmërinë e tyre me standardin Evropian; organizimin e pushtetit gjyqësor dhe raportimin e tij, administratën e pushtetit gjyqësor; administratën publike, institucionet e pavarura në sistemin e drejtësisë.)

- Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes.

(Çështjet e brendshme, të rendit, organizimin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare e publike, organizimin e Forcave të Armatosura dhe bashkëpunimin ushtarak; çështjet e

organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, emergjencat civile dhe mbrojtja nga fatkeqësitë, shërbimet sekrete.)

- Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet.

(Çështjet në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, inovacionit dhe politikave të zhvillimit të sportit.)

- Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale.

(Çështjet lidhur me politikave shëndetësore, sigurimet shoqërore, familjen, gruan dhe çështjet për mirëqenien sociale.)

- Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm.

(Çështjet në fushën e energjisë, burimeve natyrore dhe biodiversitetit, infrastrukturën, industrinë dhe telekomunikacionin, rregullimin e territorit, tregtinë dhe mbrojtjen e mjedisit dhe çështjet për zhvillimin e qëndrueshëm.)

- Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik.

(Çështjet në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, çështjet lidhur me veprimtarinë e mediave audiovizive dhe informimit dhe çështjet për garantimin e lirisë së shprehjes.)

- Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural.

(Çështjet e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, çështjet e zhvillimit rural, çështjet e kontrollit dhe garantimit të sigurisë ushqimore, monitorimin e zbatimit të politikave në fushën e bujqësisë dhe të sigurisë ushqimore.)

- Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën.

(Çështjet e kulturës kombëtare dhe trashëgimisë kulturore; zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm; politikave për ruajtjen e identitetit kulturor e gjuhësor të diasporës dhe të pjesëmarrjes së saj në proceset politike dhe sociale në vend.)

- Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme.

(Çështjet e integrimit evropian, përafrimi i legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Evropian; mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë; monitorimi i negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian, politikave të jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.)

- Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.

(Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të strategjive, rezolutave, vendimeve dhe planeve të veprimit të Kuvendit; shqyrtimi dhe ndjekja e nismave të qytetarëve dhe peticioneve; realizimi dhe koordinimi, mbikëqyrja dhe kontrolli i zbatimit të ligjeve nga ekzekutivi, institucionet dhe agjencitë e pavarura prej tij, përmes koordinimit të procesit parlamentar për



kontrollin postlegjislativ (PLS); koordinimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.)

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Kudo në Rregulloren e Kuvendit emërtesat e komisioneve të përhershme zëvendësohen sipas emërtesës së komisioneve të përhershme në nenin 19, pika 1, të këtij vendimi.”.

Neni 2

Në nenin 20 pika 3 shfuqizohet.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 16.9.2025.

VENDIM
Nr. 58/2025

PËR ZGJEDHJEN E
ZËVENDËSKRYETARËVE TË
KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 9 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjidhen zëvendëskryetarë të Kuvendit deputetët:

Klodiana Spahiu PS

Agron Gjekmarkaj PD

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 16.9.2025.

VENDIM
Nr. 59/2025

PËR PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE
TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 10/1, 10/2, 10/3, 10/4, 10/5, 10/6 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjidhen sekretariatet e Kuvendit si më poshtë:

Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit:

1. Milva Ekonomi	sekretare	PS
2. Belind Këlliçi	sekretar	PD
3. Evis Kushi	anëtare	PS
4. Anila Denaj	anëtare	PS
5. Igli Cara	anëtar	PD

Sekretariati për Procedurat dhe Votimet:

1. Ulsi Manja	sekretar	PS
2. Saimir Hasalla	anëtar	PS
3. Arkend Balla	anëtar	PS
4. Blend Himçi	anëtar	PD
5. Saimir Korreshi	anëtar	PD

Sekretariati për Statusin e Deputetit:

1. Flamur Hoxha	sekretar	PD
2. Besa Spaho	anëtare	PS
3. Ceno Klosi	anëtar	PS

Sekretariati për Kërkimin Parlamentar,
Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare:

1. Fatmir Xhafaj	sekretar	PS
2. Erion Malaj	anëtar	PS
3. Greta Bardeli	anëtare	PD

Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë:

1. Taulant Balla	sekretar	PS
2. Igli Hasani	anëtar	PS
3. Tritan Shehu	anëtar	PD

**Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit:**

1. Blendi Klosi	sekretar	PS
2. Bora Muzhaqi	anëtare	PS
3. Besart Xhaferri	anëtare	PD

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 16.9.2025.

**VENDIM
Nr. 60/2025****PËR PËRBËRJEN E BYROSË SË
KUVENDIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e Byrosë së Kuvendit është si më poshtë:

1. Niko Peleshi	Kryetar i Kuvendit	PS
2. Klodiana Spahiu	Zëvendëskryetare e Kuvendit	PS
3. Agron Gjekmarkaj	Zëvendëskryetar i Kuvendit	PD
4. Milva Ekonomi	Sekretare për Buxhetin	PS
5. Belind Këlliçi	Sekretar për Buxhetin	PD
6. Ulsi Manja	Sekretar për Procedurat dhe Votimet	PS
7. Flamur Hoxha	Sekretar për Statusin e Deputetit	PD
8. Fatmir Xhafaj	Sekretar për Kërkimin Parlamentar, Bibliotekën e Botimet Parlamentare	PS
9. Taulant Balla	Sekretar për Marrëdhëniet me Jashtë	PS
10. Blendi Klosi	Sekretar për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit	PS

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 16.9.2025.

**VENDIM
Nr. 61/2025****PËR CAKTIMIN E KRYESIVE TË
KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, duke u mbështetur në listat e kandidatëve, të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit është si më poshtë:

Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat:

1. Milva Ekonomi	kryetare	PS
2. Erion Braçe	zëvendëskryetar	PS
3. Zamira Sinaj	sekretare	PS

Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike:

1. Ulsi Manja	kryetar	PS
2. Damian Gjikhuri	zëvendëskryetar	PS
3. Aurora Mara	sekretar	PS

Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes:

1. Bledar Çuçi	kryetar	PS
2. Olta Xhaçka	zëvendëskryetar	PS
3. Ilirjan Pendavinji	sekretar	PS

Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet:

1. Evis Kushi	zëvendëskryetar	PS
2. Hatixhe Konomi	sekretare	PS

**Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien****Sociale:**

1. Eduard Shalsi	zëvendëskryetar	PS
2. Enriketa Jaho	sekretare	PS

Komisioni për Burimet Natyrore, Infras-trukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm:

1. Anila Denaj	kryetar	PS
2. Ceno Klosi	zëvendëskryetar	PS
3. Ilva Gjuzi	sekretare	PS

Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik:

1. Iris Luarasi	zëvendëskryetar	PS
2. Ardit Bido	sekretar	PS

Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural:

1. Blendi Klosi	kryetar	PS
2. Fadil Nasufi	zëvendëskryetar	PS
3. Saimir Hasalla	sekretar	PS

Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën:

1. Erion Malaj	zëvendëskryetar	PS
2. Arkend Balla	sekretar	PS

Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme:

1. Igli Hasani	kryetar	PS
2. Bora Muzhaqi	zëvendëskryetar	PS
3. Marjana Koçeku	sekretar	PS

Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale:

1. Fatmir Xhafaj	kryetar	PS
2. Ermal Elezi	zëvendëskryetar	PS
3. Aulona Bylykbashi	sekretar	PS

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 16.9.2025.

URDHËR

Nr. 7, datë 17.9.2025

**PËR DELEGIMIN E PËRFAQËSIMIT
LIGJOR
TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 76 të Kushtetutës, të neneve 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 7, pika 1, dhe 121 të Rregullores së Kuvendit,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

3. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

4. Modeli i autorizimit për përfaqësim në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

5. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor/gjykim në Gjykatën Kushtetuese bëhet nga autoriteti i përcaktuar në pikën 1 dhe në pamundësi të tij, rast pas rasti, nga personat e përcaktuar me autorizim të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

6. Autoriteti i përcaktuar në pikën 1, personi që do të përfaqësojë Kuvendin, autorizohet për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile/penale/gjykimit në Gjykatën Kushtetuese.

7. Përfaqësimi i Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore/Gjykatën Kushtetuese, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga



legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në të gjitha nivelet përkatëse të gjykimin.

8. Urdhri nr. 52, datë 1.8.2024, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë” shfuqizohet.

9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Niko Peleshi

Nr. ____prot. (vendndodhja), më _____.2025

LIDHJA 1

AUTORIZIM

**Për përfaqësimin në çështjen
administrative/civile/penale
dhe në Gjykatën Kushtetuese**

Paditës/kërkues

I paditur/subjekt i interesuar

Objekt _____

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe urdhrit të Kryetarit të Kuvendit nr. ____, datë _____.2025, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë.

VENDOSA:

Autorizimin e z/znj. _____, me detyrë _____, për të përfaqësuar Kuvendin e Shqipërisë në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative, civile, penale, gjykim në Gjykatën Kushtetuese me objektin e sipërcituar deri në shpalljen e vendimit në gjykatën

kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve përkatëse/ Gjykatën Kushtetuese.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

URDHËR
Nr. 120, datë 1.9.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të ligjit nr. 118/2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për dhënien e licencës për subjektet të cilat ushtrojnë veprimtarinë si trup inspektimi i mjeteve që kryejnë transport të disa mallrave të rrezikshme, në përputhje me parashikimet në ligjin nr. 118/2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli.

2. Në ushtrimin e kompetencës së deleguar, z. Ami Kozeli, ndjek dhe zbaton procedurat dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 118/2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.

3. Kompetenca e deleguar, sipas pikës 1, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri deri në miratimin e një urdhri të dytë.

4. Urdhri nr. 166, datë 26.7.2024, i zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË**
Belinda Balluku
Faqe | 21439

**URDHËR****Nr. 121, datë 1.9.2025****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 258, datë 27.4.2023, “Për përcaktimin e kushteve, kriterëve, procedurave të shqyrtimit dhe të vendimmarrjes, formatit dhe afateve për dhënien e autorizimit për përdorim civil të lëndëve plasëse”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli, për nënshkrimin e:

a) aktmiratimeve dhe aktrefuzimeve për aplikimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për t’u pajisur me leje minerare;

b) njoftimeve për fillimin e procedurave të revokimit të lejeve minerare;

c) njoftimeve për ndërprerjen e procedurave të fillimit të revokimit të lejeve minerare;

d) vendimeve për revokimin e lejeve minerare;

e) akteve për pasqyrimin dhe miratimin e ndryshimeve të të dhënave në lejet minerare;

f) aktmiratimeve dhe aktrefuzimeve për zgjatjen e afateve, ndryshimin e koordinatave, transferimin e lejeve minerare;

g) akteve të dhënies së të drejtës së aplikimit në QKB, për zonat e hapura për qëllime publike;

h) akteve për miratimin e nënkontraktimeve;

i) shkresave të korrespondencës me QKB-në për sektorin mineral;

j) miratimit/refuzimit të aplikimeve për autorizimet për personat juridikë privatë ose publikë, vendas apo të huaj, për përdorim civil të lëndëve plasëse;

k) urdhrave për kthimin/moskthimin e garancive financiare të rehabilitimit dhe investimit;

l) urdhrave për miratimin e projekteve shtesë të veprimtarive minerare.

2. Në ushtrimin e kompetencave të deleguara, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli, ndjek dhe zbaton parashikimet e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 258, datë 27.4.2023, “Për përcaktimin e kushteve, kriterëve, procedurave të shqyrtimit dhe të vendimmarrjes, formatit dhe afateve për dhënien e autorizimit për përdorim civil të lëndëve plasëse”; të vendimit nr. 942, datë 17.11.2010, “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”, të ndryshuar; të vendimit nr. 741, datë 9.9.2015, “Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare”, të ndryshuar; dhe të udhëzimit nr. 17, datë 28.1.2015, “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e nënkontraktimit të së drejtës së lejes minerare, për kërkim-zbulim, për shfrytëzim apo për kërkim-zbulim-shfrytëzim”.

3. Kompetenca e deleguar, sipas pikës 1, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri deri në miratimin e një urdhri të dytë.

4. Urdhri nr. 210, datë 30.9.2024, i zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
Belinda Balluku**

**URDHËR****Nr. 570, datë 12.9.2025****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 15.9.2025 deri në dekretimin e ministrit të Drejtësisë, te zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 48 lekë